



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 178, Datë 29.06.2026

MBI

KËRKESËN E SHOQËRISË “IDI 2005” SH.P.K. PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 8.8 MW

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 11, pika 3, e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 10, pikat 1 dhe 3, dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.06.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1899/1 prot., datë 25.06.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “IDI 2005” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 8.8 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1899 prot., datë 18.06.2026, ajo ka paraqitur kërkesën për modifikimin e Aneksit A të licencës së saj, duke shtuar në të dhe sistemet e akumulimit/depozitimit të energjisë, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 8.8 MW.
- Ky aplikim vjen në rrethanat kur në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 534, datë 25.09.2025, si dhe Kontratën me nr. 1888 rep., nr. 1013 kol., datë 29.10.2025, të nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, referohet e drejta Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 8.8 MW, dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale 3038, Fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “IDI 2005” sh.p.k.
- Në nenin 11, pika 3, e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, parashikohet se: “Prodhuesit me përparësi kanë të drejtë të përdorin objektet e

tyre ose objekte të tjera të depozitimit duke mbuluar të gjitha kostot për të zbutur efektin e disbalancës dhe, në rast se skemat e tyre mbështetëse e lejojnë, të përfitojnë nga diferencat për orë përmes zhvendosjes së injektimit në rrjet”.

- Rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores dhe nuk ka detyrime të pashlyera në lidhje me pagesat e rregullimit.

2. Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 15, pika 4, e Rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për modifikimin e licencës sipas gërmave (a, c, d, e, f dhe g).
- Në referencë të përcaktimeve të nenit 15, pika 4, gëma “b” të Rregullores, shoqëria duhet të bëjë saktësimin përkatës të veprave ndihmëse dhe të kapacitetit të secilës.
- Në lidhje me fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë sipas kërkesës së saj, vlerësohet që të njoftohet dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “IDI 2005” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 289, datë 13.11.2025, për prodhimin e energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 8.8 MW, duke shtuar veprat ndihmëse/njësitë e depozitimit të energjisë elektrike në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të instaluar të centralit.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “IDI 2005” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” (OSSH) sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI